


# Senatorja për fëmijët dhe edukimin



Senatorja për fëmijët dhe edukimin • Rembertiring 8-12 • 28195 Bremen

Informacioni i siguruar  
Helena Justa

Për  
Të gjithë Prindërit ose Kujdestarët ligjor

Dhoma 411

Tel. 0421 361-12604  
Fax 0421 496-12604

E-Mail:  
helena.justa@  
kinder.bremen.de

Shënimi im  
(ju lutem specifikojeni  
në përgjigje) 30-1

Bremen, 04.05.2021

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Të dashur prindër ose kujdestar ligjor,

prej një viti Corona po ndryshon përditshmërinë tonë. Ne duam të kontribuojmë që njerëzit në kopësht të mos infektohen me virus. Gjithashtu ne duam ti mbajmë ambjentet e hapura për të gjithë fëmijët për atë kohë sa të jetë e mundur. Sot po ju informoj rreth një mase të re për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësve në kopësht.

Përmes kopshtit tuaj ju do të merrni së shpejti teste të shpejta për fëmijën/jët tuaj. Këto teste janë zgjedhur nën mbikqyrje shkencore dhe nuk janë të rrezikshëm për fëmijët. Testimi i fëmijës suaj është vullnetarisht. Megjithatë unë ju lutem shumë që të testoni fëmijën tuaj dy herë në javë. Ju do të bëni testin tek fëmija/jët tuaj të hënave dhe të enjteve në shtëpi, përpara ardhjes në kopësht. Kështu ju ndihmoni në mbrojtjen e shumë fëmijëve. Në qoftë se e keni harruar testin në shtëpi, ju keni mundësi që ta bëni testin edhe në kopësht.

Në qoftë se rezultati është negativ, plotësoni ju lutem fletën e bashkëngjitur të rezultatit dhe dorëzojeni atë në kopësht në të njëjtën ditë.

Në qoftë se rezultati është pozitiv, fëmija juaj nuk lejohet të vij në kopësht dhe duhet që të qëndroj në shtëpi. Ju lutem informoni menjëherë kopshtin tuaj me telefon. Pastaj organizoni ju lutem një takim për një test PCR për të kontrolluar edhe një herë rezultatit. Për ta bërë këtë telefononi **361 10100**. Në qoftë se edhe rezultati PCR është pozitiv, ju lutem informoni kopshtin tuaj. Fëmija juaj duhet të rrij në izolim. Edhe ju vet duhet të testoheni

Në qoftë se rezultati është negativ, fëmija mund të vij në kopësht.



Hyrja:  
An der Weide 50

Shërbimet:  
An der Weide 50  
28195 Bremen

Bus/Tram:  
Stacion  
Stacioni qendror

Orari:  
e hënë-e premte  
9:00 – 14:00

Të dhënat e bankes:  
Deutsche Bundesbank  
DE 16 2500 0000 0025 0015 30  
Sparkasse Bremen  
DE 73 2905 0101 0001 0906 53

## Informacione rreth procedurës

Ju lutem zhvillojeni testin:

- Dy herë në javë (të hënave dhe të enjteve)
- Me fëmijët në shtëpi
- Përpara ardhjes në kopësht

Një vidjo për zhvillimin e testit e gjeni ne faqen kryesore të Senatores për Fëmijët dhe Edukimin.

(<https://bildung.bremen.de/sixcms/detail.php?gsid=bremen117.c.237989.de>)

### Rezultat negativ i testit



Fëmija juaj mund të vij në kopësht.



Plotësoni fletën e bashkëngjitur të rezultatit. Ju lutem dorëzojeni atë ne kopësht.

### Rezultat pozitiv i testit



Fëmija juaj duhet të rrij në shtëpi.



Ju lutem raportoni rezultatin e testit në kopësht.

&

Ju lutem zhvilloni një test PCR tek fëmija juaj. Për ta bërë këtë telefononi:  
0421 361 10100



Informoni kopshtin rreth rezultatit.







-> Me rezultat negativ të testit PCR fëmija juaj mund të vij ne kopësht përsëri






-> Me rezultat pozitiv të testit PCR, informoni kopshtin tuaj. Fëmija juaj duhet të izohet.

## Informacione të tjera rreth testit

- Testi është për *Novel Coronavirus (COVID 19)*, pako me test antigjeni (*Colloidal Gold*) NASAL nga LYTHER®.
- Testi është i aprovuar si nga Instituti-Paul-Ehrlich ashtu edhe nga Instituti Gjerman për Medikamentet, gjithashtu edhe për fëmijë.
- Provëza merret në zgavrën e përparme të hundës.
- Ju lutem lexoni udhëzimet shoqëruese para se të kryeni testin dhe zhvillojeni atë tek fëmijët tuaj me duar të lara.

### Hapat kryesore janë:

<p>1. Merrni shufrën e pambukut (pa e prekur pjesën e pambukut në fund të shufrës) nga pakoja e testit dhe futeni me kujdes në një nga vrimat e hundës së fëmijës tuaj 1-2 cm deri sa të hasni në rezistencë.</p>	
<p>2. Rrotullojeni shufrën e pambukut në vrimën e hundës së fëmijës suaj 5 herë në muret e hundës.</p> <p>3. Nxireni shufrën e pambukut nga vrima e parë e hundës dhe futeni në vrimën tjetër në të njëjtën mënyrë. Rrotullojeni shufrën atje gjithashtu 5 herë.</p>	 <p>Innerhalb 7-10 Sek. 5-mal drehen    Innerhalb 7-10 Sek 5-mal drehen <i>Brënda 7-10 sekondash rrotullojeni 5 herë</i></p>
<p>4. Hapni tapën dhe zhysni shufrën e pambukut në tubin e provëzës.</p> <p>5. Shtypni tubin e provëzës 10-15 herë, në mënyrë që muret e provëzës të prekin shufrën e pambukut.</p> <p>6. Prisni 1 minutë</p>	
<p>7. Nxirni shufrën e pambukut dhe mbyllni majën e pikatores ("Kapakun") e tubit.</p>	


<p>8. Merrni provëzën e testit dhe hidhni 3 pika nga tubi në vrimën e testit (S).</p>	
<p>9. Pas 15 minutash mund të lexoni rezultatin e testit</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: flex-start;"> <div style="text-align: center;">  <p><b>POSITIV</b> <b>POZITIV</b></p> </div> <div style="text-align: center;">  <p><b>NEGATIV</b> <b>NEGATIV</b></p> </div> <div style="text-align: center;">  <p><b>UNGÛLTIG</b> <b>I PAVLEFSHËM</b></p> </div> </div>	

Çfarë mund të bëni kur jeni të pasigurt?

- Ju mund ta përsërisni testin edhe njëherë, ose mund të shkoni në një qendër testimesh dhe të bëni atje një test të shpejtë falas.
- Në rast pyetjesh mund të përdorni në çdo kohë linjën telefonike 0421 361 10100. Ne do t'ju ndihmojmë me kënaqësi.

Gjithë të mirat

Pergjegjës



Shef i departamentit për edukimin në fëmijërinë e hershme, promovimin e fëmijëve dhe zhvillimin profesional.